



Republika e Kosovës * Republic of Kosova
Komuna * Municipality
Hani i Elezit



DATE: 08.10.2021

NR.09/ 7788 /2021

KONTRATË PËR FURNIZIM

Numri i kontratës ¹: 659-21-5897-5-5-8/C211 & 029/2021

KOMUNA HANI I ELEZIT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), perfaqësuar nga Xhevdet BUSHI në njërin anë; dhe

ARITECH, PRISHTINË - LIPJAN KM.10- PËRBALLË QMI- SË, GRACANICA, me NUI.810821828 (në vazhdim "Furnizuesi"), Perfaqësuar nga Fahri Avdiu, në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative me numër identifikues: 659-21-5897-5-5-8

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

Nr.	Grupi
1	Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë **5 nga koha e porosisë apo nga koha e lëshimit të urdhër blerjes** nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë **Komuna Hani i Elezit**.

2.3 Inkotermi² i zbatueshëm do të jetë .

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **1,111.40 €**; [Njëmij e njëqindë e njëmbdhjetë euro e katerdhjetë centi] Euro.

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

[Nëse disa artikuj iu nënshtrohen ndryshimeve]

Çmimet e artikujve që janë subjekt të rregullimit të çmimit janë subjekt i rregullimeve në vijim: [shëno indeksin ose burim tjetër të rregullimit të çmimeve]

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

² Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.



6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.



6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

3 në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Xhevdet BUSHI
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	08/10/2021
Vula:	

Për Furnizuesin

Emri:	Fahri AVDIU
Pozita:	Drektor
Nënshkrimi:	
Data:	08.10.2021
Vula:	

³ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 659-21-5897-5-5-8/C211

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

<i>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</i>		<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i>
<i>Përshkrimi i nenit</i>	<i>Nr. Nenit</i>	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	9.1	<i>[Sigurimi i ekzekutimit në 10% e vlerës së kontratës me afat prej 2 muajve apo 60 ditë]</i>
Sigurimi	10.1	
Programi i ekzekutimit	11	<i>[Konform kohëzgjatjes së kontratës prej një (5) ditëve nga koha e nënshkrimit të kontratës]</i>
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	12.1	Furnizuesi do të jetë plotësisht përgjegjës për pagesën e të gjitha taksave, detyrimeve të pullës, taksat e licencave, tarifat doganore dhe taksat tjera që lindin apo imponohen deri në dorëzimin e Mallrave të kontraktuara në vendin e dorëzimit, siç është përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues
Patentat dhe licencat	13.1	Furnizuesi do ta sigurojë autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat që janë rezultat i përdorimit të patentave, licencave, skicave, modeleve ose markave apo emrave tregtarë siç është specifikuar në kontratë, përveç nëse shkelja e tillë është rezultat i veprimit sipas dizajnit ose specifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktues.
Cilësia e furnizimeve	18.2	Furnizimet duhet t'i plotësojnë specifikimet teknike të paraqitura në kontratë në të gjitha aspektet dhe të jenë konform në të gjitha aspektet me skicat, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë, të cilat duhet të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë periudhës së realizimit të kontratës. 18.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare të parapara në KVK duhet të bëhen me kërkesë të dërguar nga furnizuesi i për autoritetin kontraktues. Në kërkesë do të saktësohen materialet, artikujt dhe mostrat e dorëzuara për këtë pranim sipas kontratës dhe të tregojë numrin e sasisë dhe vendin ku do të bëhet pranimi në mënyrë e duhur. Materialet, artikujt dhe mostrat e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në furnizime. 18.3 Edhe nëse materialet apo artikujt që do të inkorporohen në furnizime ose në prodhim të komponentëve që do të furnizohen janë pranuar teknikisht në këtë mënyrë, ato prapë mund të refuzohen nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime, dhe në këtë rast ato duhet të ndërrohen menjëherë nga furnizuesi. Furnizuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikujt do të pranohen për inkorporim në furnizime vetëm nëse janë riparuar dhe janë përmirësuar në atë mënyrë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.
Inspektimi dhe testimi	19.2	Furnizues do të sigurojë që furnizimet të dorëzohen në vendin e pranimit me kohë që t'i mundësohet autoritetit kontraktues të vazhdojë me pranimin e furnizimeve. Furnizuesi konsiderohet se i ka paraparë plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe atij nuk do t'i lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë. 19.2 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshhtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshhtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vendin e pranimit apo në vendet që

		<p>janë specifikuar në KVK.</p> <p>19.3 Për qëllime të testimeve dhe inspektimeve të tilla, Furnizues do të:</p> <p>a) I japë autoritetit kontraktues, përkohësisht dhe pa pagesë, ndihmë, mostra ose pjesë për testim, makina, pajisje, vegla, punë, materiale, skica dhe të dhëna të prodhimit që zakonisht kërkohen për inspektim dhe testim;</p> <p>b) Të merret vesh me autoritetin kontraktues për vendin dhe kohën e testimeve;</p> <p>T'i japë autoritetit kontraktues qasje në çfarëdo kohe të arsyeshme në vendin ku do të realizohen testimet</p>
Pagesa	20.1	<p>Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Furnizuesi do të bëhen në llogarinë bankare. Shumat duhet të paguhesh brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.</p> <p>Periodha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Furnizuesin që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Periodha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur</p>
Dorëzimi	21.3	<p>Furnizuesi duhet t'i dorëzojë furnizimet në pajtim me kushtet e kontratës. Furnizimet do të jenë në përgjegjësi të Furnizuesit deri në pranimin e tyre të përkohshëm.</p> <p>Furnizuesi do t'i paketojë furnizimet ashtu siç kërkohet për të parandaluar dëmtimin apo keqësimin e gjendjes së tyre gjatë transportit deri në destinacionin e tyre, siç është dhënë në kontratë. Paketimi duhet të jetë i mjaftueshëm për të përballuar pa kufizime, bartjen e ashpër, ekspozimin në temperatura ekstreme, kripën dhe rëniet gjatë tranzitit dhe mbajtjen në ambient të hapur. Madhësia e paketimit dhe pesha duhet t'i përshtaten, nëse është e mundur, largësisë së destinacionit përfundimtar të furnizimeve, dhe mundësisë së mungesës së pajisjeve për bartje të rëndë në të gjitha pikat gjatë transitit</p>
Menaxher i kontrates	21.4	Menaxher i kontrates do të jete Bashkim Sopa- Zyrtar i IT-se
Obligimet e garancionit	24.1	Furnizuesi do të garantojë që furnizimet të jenë të reja, të papërdorura dhe sipas specifikimit me dosje të tenderit
	24.5	<p>Aplikohet garancioni për produktet 36 apo 3 vite, të deshmuar me fletgarancion nga OE</p> <p>Fletgarancioni leshohet në momentin e dorëzimit të furnizimit dhe pranimit nga AK-ja.</p>
Shërbimet pas shitjes	25.1	<i>Garancion për paisjet prej 36 muajve po 3 vite nga momenti i pranimit të furnizimit nga AK-ja.</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	Zyra e Prokurimit – Komuna e Hanit të Elezit ose Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	<p><i>[shëno te dyja]</i></p> <p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>[Gjykata Themelore Prishtinë-Departamenti për çështje ekonomike]</i> në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>ose</p> <p>b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <i>[specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes]</i> në pajtim me <i>[specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].</i></p>